


BIBLIOTEKA

BJH-32

P 31

RAMADAN M. PASMAÇIU



DY SHOKËT

8JH-52  
P31.

RAMADAN M. PASMAÇIU

R

# D Y SHOKËT

— NOVELË —

Për fëmijët e moshës së mesme shkollore.

SHTEPIA E SHTETIT  
GJERGJASISF

36093

31-767

1.

Dielli po anonte nga Shpiragu. Mali i Goricës dhe kalaja, nën rrezet e tij, tashmë jo fort të ndritëshme, ngjanin si të mbuluara nga një ngjyrë e verdhë dhe e kulluar. Selvia e lartë te sheshi i xhamisë së plumbit bënte hie të gjatë e të zbehtë, që shtrihej nga ana e kodrës së Shënthanasit.

Tek-tuk, nëpër rrugën që kalonte mbi shtëpinë e priftit, dukeshin fshatarë me nga ndonjë kalë, a gomar përpara, duke shpejtuar që të mos i zinte nata pa arritur në fshat. Shpesh dëgjoheshin zërat e tyre: «Ysh, ysh të çaptë ujku, se u ngrys!» Por, herë-herë, përmbi këta zëra dëgjohej më shumë gega, që shiste ëmbëlsira:

«Ecni, çuna, ke daj' Mani,  
Nëpër duer paret mos i mbani!  
Me hallva e mafishe daja jua ndrron,  
Menjiherë gojën jua ambëlson.  
Ecni, se daja sot ka xhepin bosh,  
Nesër jua fali, pa kërkue një grosh.  
... Çe, çe, ja mbrritën çunat ke daja,  
Tash po jua zgiedhi copat ma t'mdhaja!...»

Sa i çuditshëm ishte gega! Gjithmonë ashtu thoshte: «Sot daja e ka xhepin bosh, nesër s'ju marr asnji grosh.»

Atë pasdite ai qe shumë i gjëzuar. Thërriste pareshtur dhe shkëlqente i téri. Portofoli po i fryhej nga çasti në çast. Dhe nuk kishte si të ndodhë ndryshe. Në shkollën shtatë vjeçare: «22 Tetori» sapo qenë ndarë dëftesat. Prindët po largoheshin pak e nga pak, kurse nxënësit po loznin të shkujdesur nëpër oborr. Ishin më tepër se 200. Daj' Mani i tërhiqte si me magnet nga dy a nga tre, e katër e nga pesë, që andej nga cepi i rrugës që kalonte pranë shkollës. Veçse çunave të klasave të treta zëri i tij as që ua tërhiqte fare vëmen-djen. Ata ishin ndarë në dy grupe. Disa më kishin rrëthuar mua, e disa Kristaqin, që nuk qe as dy metra më tej.

Petraqi thoshte:

— Kristaqi di më shumë se Dritani.

Ramizi ja kthente me rrëmbim:

— Jo. Dritani di më shumë. Mësuesja jonë ishte dorështrënguar. Nuk i vinte pesat kollaj.

— Edhe mësuesi ynë ishte dorështënguar. As treshat nuk i vinte kollaj, e jo pesat, — i cirrej Ramizit Agroni.

Kristaqi më shikonte me inat dhe ngulte këmbë:

— Unë di më shumë, uni!

— Pusho, mos fol në tym! — i hiqte vë-rejtjen atij Metja.

— Pusho ti! Ai mirë e ka, — ja priste Metes Edmondi.

— Jo, nuk e ka mirë!

— E ka!

— S'e ka!

Ata po haheshin me fjalë aq shumë sa nuk po i hidheshin në grykë njeri-tjetrit. E, pastaj, me siguri, do të shpërthente grindja në mes të dy grupeve. Por ndërhyri Festimi dhe gjëndja ndryshoi menjëherë.

— Ej, çuna! — bërtiti ai. — Ja, ç'them unë: Përse të zihemi? Më mirë të rraken përbeli Dritani dhe Kristaqi. Atë që të fitojë ta quajmë më të ditur, se kështu s'kemi si t'ja bëjmë. Të gjitha pesa i ka njeri, të gjitha pesa i ka tjetri.


— O, sa mendim i mirë! — thirrën çunat.

Unë dhe Kristaqi ishim të dy me pantalona të shkurtra. Të dy me sandale. Të dy të një moshe. Ai vinte i mbushur, faqefryrë, e symadh; unë i hollë e thatim. Disa prej shokëve na kishin vënë edhe nofka: Kristaqit — bullafiq, mua — karkalec.

— E, Dritan, — më pyeti Festimi, — do rrokesh?

— Do rrökem, — iu përgjegja i nxehur.

— Ai po më shet mënd. Mburraveci!



— Po ti, Kristaq?

— Jo, unë nuk rrokem, se më rreh babi.

Në këtë çast, çunat i thanë:

— Ikë, ikë, frikacak! Dhe, mos shit mend më! Duket që nuk je i zoti. Dritani di më shumë se ti, njëqind herë më shumë.

Ramizi thirri:

— Një «urra!» për Dritanin!

Të tjerët ja pritën:

— Urraaa!...

— Edhe një herëëë!...

— Urraaa!...

## 2.

Pas disa ditësh mua nuk po më vinte mirë për atë që kish ndodhur në oborrin e shkollës. Kristaqi vërtet qe treguar mburravec, po edhe unë s'kisha bërë mirë që kisha pranuar të rrokesha, sidomos në një kohë kur po ndaheshim, kur nuk do të vinim si çdo ditë në shkollë, po do të shkonim andej-këndej për pushimet e verës. Më kujtohej sa më dëshpërim qe languard ai. Kjo gjë më mundonte. Po ta takoja gjékundi, do t'i flisja patjetër. Ndofta do t'i thoshja edhe «më fal!».

Me këto mendime në kokë po shkoja në furrë për të blerë bukë. Kur, në radhë pasqë Kristaqin. Ishte i fundit. Duhej të zija vënd pas tij. Iu afrova dhe e përshëndeta:

— Mirë dita!

Ai jo vetëm që nuk m'u përgjegj, po edhe më ktheu shpinën. Nuk e them dot sa u preka! Pas pak erdhi për të mbajtur radhën pranë meje një burrë i panjohur. Atë kohë Kristaqi u kthyte papritur nga unë dhe më tha:

— Pse shite mënd atë ditë?


— Paske harruar, — iu përgjegja, — ti thoshe: «Unë di më shumë, unë».

— Mirë thosha. Pse, nuk është ashtu?

— Po ne s'jemi provuar ndonjë herë.

Burri i panjohur, që po na dëgjonte më vëmëndje, ndërhyri në bisedën tonë:

— T'ju provoj unë? ’



— Provona! — ja priti Kristaqi, duke tundur kokën. Dhe burri vazhdoi:

— Kush e gjen nga ju, sa bëjnë 120 dhe 773, shumëzuar për 2511, pa 432, edhe 1549, pa 9214 herë 3?

— Përmendësh? — pyetëm të dy me një gojë.

— Posi, përmendësh.

— Unë e... e gjeja, po... tani më është lodhur koka nga vapa, — mërmëriti Kristaqi.

— Po ti e gjen dot? — m'u kthye burri mua.

— Jo.

— E shikon? Të dy s'qënkeni gjë, — tha ai, — prandaj s'kini përse të mburreni. Tani, hajt, të blejmë bukë, se na erdhi radha!

### 3.

Nuk e kuptoja si kaluan aq shpejt pushimet verore. Më dukej sikur Një shtatori kish vrapuar drejt nesh si rrathët tanë drejt shtëpisë së xha Kadriut, kur i lëshonim tatëpjetë rrukullimës nga bahçeja e Agimit. Oborri i shkollës atë mëngjes shushurinte si gjethë ples-pash, kur fryn erë e madhe. Të gjithë qemë mbledhur atje që në orën shtatë. Disa takoreshin me njeri-tjetrin dhe fillonin, aty për aty,

ndonjë lodër, disa shikonin Pëllumbin tek rrotullohej në paralele, të tjerë bridhnin përqark mureve të shtëpive të djegura përkundrejt. Unë po kërkoja me sy Kristaqin. Nuk dija ç'më shtynte të takohesha me 'të. Mbase, nga që nuk e kisha parë asnijë herë, veç asaj dite në furrë; ose, nga që isha shumë i gjembi dhe i mallëngjyer. Më në fund e gjeta. Po rrinte me pesë a gjashtë shokë, mbështetur pas murit të rrugës. Qe veshur me rroba të reja e me pantallona të gjata ngjyrë kafe. Bluzën e kish si të marinarëve, të kaltër me vija të bardha. Kë-pucët e zeza gjysma i ndrinin si pasqyrë. Kokën e kish qethur dhe faqet i kuqonin. Në dorë mbante një trëndafil. Iu afrova që t'i flisja, po ai bëri sikur nuk më pa dhe vazhdoi të qeshte me qyfyret e Lonit të Cacës. Atëhere u largova duke qortuar veten. Pse i ngjitesha prapa? Apo mos vallë më mungonin shokët? Apo që të kujtonte se do t'ja kisha nevojën? Bëra be se nuk do t'i afrohesha kurrë. Ai, po të donte, le të më fliste. I kisha dalë nga borxhi.

Ndërkohë shërbyesi i shkollës, xha Todi, doli në oborr dhe nisi t'i bjerë ziles. Dhe zilja ushtonte: «Tringi-ringi, tringi-ringi!...» Sa po më gjëzonte ajo oshëtimë! Sa e ëmbël, sa e bukur po më dukej! Kisha tre muaj pa e dëgjuar, Çudi! Edhe xha Todi atë mëngjes po më ngjante shumë tërheqës, shumë i ri. Me njerën dorë

mbante cigaren e ndezur, me tjetrën tundëte zilen. Plot djem thërrisnin:

— Bjeri, xha Todi, bjeri! Fort, fort!

Mua do të më pëlqente ta dëgjonte tringiringen e ziles së shkollës sonë gjithë Berati.

U vumë në rresht. Dëgjuam përshëndetjen e drejtorit. Pastaj mësuese Shpresa tha:

— Klasat III të vijnë pas meje!

Festimi me Ramizin, që ishin në rachën e parë, i vajtën pas.

— Ej, ej, ku shkoni?! — u thirrëm atyre.

— Jemi në klasën IV tani, harruat?

Ata u ndalën dhe u kthyen në vend. Të gjithë qeshëm.

— Ju ngjituni në katin e sipërm dhe hyni në derën përballë! — na porositi nëndrejtori.

Atje u bëmë më tepër se gjashtëdhjetë nxënës. Ishim dy klasa bashkë. U ulëm nëpër banga, nga katër e nga pesë. Pas disa minutash erdhën tek ne dy mësues. Njërin e njihnim, se kish vjete në shkollën tonë. E quanin Astrit Rama. Tjetrin nuk e kishim parë ndonjëherë. Dukej që kish ardhur për herë të parë. Mësues Astriti nxori një copë kartë nga xhepi dhe e shpalosi duke thënë:

— Ata që do të dëgjojnë emrat të rrinë këtu! Të tjerët të shkojnë me mësues Isufin!

— Pse nuk do të ndahemi ashtu si kemi qënë në klasën III? — pyeti Ramizi.

— Jo...

...Pastaj të dy mësuesit dualën jashtë. Prapa tyre shkuan duke zhurmëruar, nxënësit që u caktuan në dhomën tjetër. Në këtë kohë Festimi thirri:

— O, o, çfarë mrekullie! Dritani dhe Kristaqi ranë në një klasë. Tani do të shikojmë se kush di më shumë.

Pashë Kristaqin. Po queshte. Kuptohej që ishte mjaft i kënaqur. Petraqi dhe Edmondi e përkëdhelnin, duke i rënë me pëllëmbë në gjoks:

— Buçko! Tani do ta marrë vesh Dritani sa i zoti je ti.

— S'do mënd, — përgjigjej ai.

— Urraaaa!... S'ka si Kristaqi ynë! — cirreshin ata.

Tek unë erdhën shpejt Festimi dhe Ramizi, pas tyre edhe Meti. Të tre fërkonin duart, të gëzuar, që nuk na kishin ndarë.

— Dritan, e di vetë, — më thanë, — të gjitha pesa t'i marrësh! Hë? Mos të ta kalojë Kristaqi!

— Mirë, mirë, të gjitha pesa, — ua ktheva pa qejf!

— Asnjë katër e gjysëm, hë?

— As pesë pa, hë?

— Mirë, mirë, as pesë pa!

Që në ditët e para u binda se Kristaqi ishte vërtet një nxënës shumë i mirë në mësime.

Detyrat e arithmetikës i zgjidhët drejt e më pastër se të gjithë ne. Sipër shënonte datën dhe e nënvizonte me laps të kuq. Po ashtu nënvizonte edhe përfundimet e problemave.

Mësuesi ynë Astriti i vinte Kristaqit pesa të mëdha dhe pastaj na e tregonte neve fletoren e tij.

— Shikoni, — na thoshte, — sa bukur i ka bërë detyrat Kristaqi! Të kënaqin syrin, apo jo?

— Pooo!... — ushtonte klasa.

— Kështu t'i bëni të gjithë.

Kristaqi, posa dëgjonte këto fjalë, kthente kokën nga unë. Më shikonte drejt në sy e më dukej sikur më mburrej:

«E, kush di më shumë?»

Kur binte zilja për pushim, Kristaqin e vinin në mes Edmondi, Petraqi dhe pesë a gjash-të të tjera, dhe bërtisnin:

«Rroftë Kristaqi!»

Një herë, njëri nga shokët e Kristaqit më erdhi pranë dhe më pyeti me tallje:

— E ku je?

Po unë nuk iu përgjegja.

## 5.

Nuk kishte kaluar as edhe një muaj nga fillimi i vitit shkollor. Ishte e enjte pasdreke. Kishim ardhur të gjithë në klasë dhe po bënim mbledhjen e parë të kompanisë. Pranë tavolinës së mësuesit kish zënë vend presidumi: Zoi Gjika, nxënësi i klasës VI, i deleguar nga organizata e pionierit e shkollës, Elsa dhe Metja. Pasi diskutuam për përparimin dhe disiplinën në klasën tonë, Elsa tha:

— Tani le të fillojmë nga propozimet për komandantin e kompanisë dhe për tre skuadër-komandantë!

Menjëherë klasa u vu në lëvizje.

— Me leje? — ngriti gishtin i pari Petraqi.

— Folë! — i thanë nga presidumi.

— Unë propozoj Kristaqin. Vjet ai doli me të gjitha notat pesa. Edhe sivjet, gjer më tanë, nuk ka marrë asnje katër...

— Me leje, me leje? — bërtiti Festimi, duke e ndërprerë Petraqin.

— Prit! Pse ngute? — i tërhoqën vërejtjen Festimit. — Dale të mbarojë tjetri!

— Jo, unë kaq pata, — tha Petraqi.

— Mirë. Folë ti, Festim!

— Unë nuk jam në një mendje me Petraqin. Kristaqi është mburravec dhe... përpinqet

vetëm për vete. Një ditë unë iu luta të më shpjegonte një problem, dhe ai ma priti: «Nuk dua. Ke inat?» Pastaj vajta te Dritani. Ky ma shpjegoi menjëherë. Unë propozoj Dritanin. Është më i miri i klasës dhe nuk kursehet për shokët.

— Dritani i mirë është vërtet, po ka edhe të meta, — u hodh e tha Liljana. — Një ditë m'u afroa mua dhe më la në dorë një gjë të mbështjellë me kartë. — «Ç'është kjo?», — e pyeta, «Nuk e di, — më tha, — mëma jote m'u lut që të ta bija ty. Dhe ja ta prura».

Unë kujtova se mos qe ndonjë kulaç me sheqer dhe e hapa shpejt. Po, ç'të shikoj? Ish-te një breshkë e vogël. Sa u trëmba!

Pas meje u propozua Ramizi, po edhe ai nuk fitoi, se u zbulua që, një ditë, para se të hynte në klasë, kishte vënë tosimoni në hundë. Posa nisi mësimi, Ramizini e mbytën tesh-timat. Mësuesi kujtoi se e kishte zënë gripi, prandaj e porositi të shkonte në shtëpi, të shtrihet në shtrat, të pinte çaj të nxehetë dhe ta mbulonte kokën me jorgan. Kurse Ramizi, me të dalë nga klasa, ja shkeli për në lumë dhe u shkri duke u larë tërë paraditën.

Pas Ramizit u propozua Loni i Cacës. Po as ky nuk fitoi, se një herë i kishte ngjitur çunit të Spiros, Mitit, një copë letër pas kurrizit në

të cilën kishte shkruar me gërma të mëdha:  
«JAM ZAGAR, SHITEM NË PAZAR!» Miti i gjorë, që s'dinte gjë, e cte rrugës pa folur, kurse Safet Kaçolja me shokë, që s'rronin dot pa qyfyre, e ndiqnin nga prapa duke qeshur, e duke thirrur: «O, o, o! Ha, ha, ha! Jam zagar, shitem në pazar!» Kur e kish kuptuar Miti, që bërë flakë dhe e kishte grisur letrën me inat.

Në mbledhjen tonë do të qenë zbuluar plot «heroizma» këso llojesh, po të ishin propozuar Agroni, Edmondi, e ndonjë tjetër.

Në fund u zgjodhën Vangjeli — komandant, Elsa, Pullumbi dhe Thomai — skuadër-komandantë. Ata, ndonëse nuk shquheshin në mësimë më shumë se Kristaqi e se unë, e meritonin ta udhëhiqnin klasën, pasi, sikurse doli nga mbledhja, kish'n anë të tjera më të mira.

## 6.

Hani i Shaqir Nallbanit ishte pranë shkolles sonë. Përpara hanit ishte një shesh i madh. Ditëve të pazarit, fshatarët i jepnin xha Shaqirit nga një dhjetëlekëshe, dhe lidhni nëpër hunjët e ngulur rrëth sheshit, gomarët ose kuajt; kurse në ditët e tjera, pasdrekeve, në shesh nuk dëgjohej asnjë hingëllimë, ose e pëllitur, ose goditje çekicë mbi patkua. Në të katër anët

ndihej vetëm zhurma që bënim ne, duke lozur me top prej lecke. Xha Shaqiri nuk mërzitej, përkundrazi kënaqeje. Rrimitë këmbëkryq, ulur mbi sofatin e hanit, dhe thithët çibukun. Herëherë edhe bërtiste:

— O çuni i Soses! Bjeri, or'de, pse s'i bije?  
Hë! Ashtu, më të lumtë këmba!

Ndodhët që ne ziheshim:

— Gol!

— Jo, s'qe gol. Ishte mbi gur.

— Për kokën e babajt, gol, po them.

Në këto raste fjalën e fundit e kishte xha Shaqiri. Ai ngrihej papërtuar fare dhe vinte pranë nesh.

— Ti ku ishe, kur e zhyte topin?... Atje, hë? Mirë... Qysh thatë? Ku kaloi topi? Këtu? Ç'ne! Unë e pashë vetë. Kaloi dy pëllëmbë më këndeje.

Dhe i jepte fund:

— Gol, çuna. Vazhdoni!

Kështu që xha Shaqirin e kishim shok. Nuk mbante nga asnjë anë. Ishte një arbitër i vërtetë. Vetëm me një ndryshim: nuk vraponë pas nesh me bilbil në gojë, po arbitronte nga vëndi. Ramizi, që e kishte gjysh xha Shaqirin, kur donte ta mburrte ndonjëherë, thoshte:

— Si i ka sytë gjyshi im, si shqiponjë! Që atje tutje e shikon edhe vrimën e gjilpërës.



Në pasdreken e asaj dite ku bëmë mbledhjen e kompanisë sheshi i hanit të xha Shaqirit filloi të ketë më shumë gjallëri nga çdo herë tjetër. Që pa vajtur ora katër, qenë mbledhur atje dhjetra e dhjetra fëmijë. Skuadra «Rrufeja» e lagjes sonë «Kodra e Sulmit» do të ndeshej me skuadrën «Flaka» të lagjes «10 Korriku».

Ja cilët ishin tifozët tanë: fqinji im i vogël, Muharremi, i cili ende bridhte rrugëve me fustane; Luftari, që kish marrë me vete edhe këlyshin; Azizi, ose kampioni i kaçoleve në shatërvanin e pazarit të misrit; çuni i përkë-

dhelur i Shaqes, Fehimi; dhe Lamja, ose, siç i thërrisnim ne, kapiteni 15-vjeçar. Kurse «Flaka» kish sjellë një batalion tifozësh. Ndër ta binte në sy, sidomos, Llaqi, që kish rrëmbyer këmborën e lopës së vet për ta tundur fort, kur në portën e «Rufesë», siç mendonte ai, dë të fishkëllenin golat; dhe Loni i Cacës me një copë kartë të madhe në gjoks, ku kishte shkruar: «Ndeshje ndërkombëtare «Flaka» — «Rufeja» 13-0. Të gjithë në stadiumin «Xha Shaqiri»! Mos humbisni rastin!» Por, më në sy ndër tifozët e «Flakës» binte gjyshja e Kristaqit, Pulia. Ne e pamë atë, kur i nipi po e sillte te sheshi duke e tërhequr nga dora. Bile, dëgjuam edhe kur ai i tha:

— Gjyshe, rri këtu dhe mos luaj nga vëndi! Po, ama, jo të bësh çarape! Më shiko mua! Kam për të bërë 5 gola. Dhe ti ta mbash fjalën! Më ke premtuar 20 lekë.

— U, t'u bëftë gjyshja! — ja ktheu ajo. — Ti të më dalësh më i zoti nga të gjithë shokët, pa unë për ty edhe kokën jap.

Para se të fillonte loja, sipas zakonit, të gjithë ne lojtarët shkuam pranë xha Shaqirit.

— Kumandarët e skuadrave, — u dëgjua zëri i tij i trashë, — të afrohen më tëhu meje!

Në çast, nga ne doli Ramizi dhe nga «Flaka» Sotiri.

— Hë, — vazhdoi arbitri plak, — me nga sa lojtarë do ta bëni ndeshjen?

— Me nga 7, — iu përgjegj kapiteni i «Flakës».

— Jo, xha Shaqir, ne duam me nga 9, — ja priti kapiteni ynë.

— Atëhere po e vendos vetë, — i tha xha Shaqiri, pasi u mendua pak, — me nga 8 lojtarë të bëhet ndeshja! Mos e zgjatni më këtë muhabet! Tani, hajt, shtini çift a tek për të zgjedhur portat!

Dy kapitenët mbyllën duart grusht dhe, si i ngritën përpjetë, i shtrinë përpara duke hapur gishtat e duke thirrur: «Ç...i.f.t, a t...e..k!»

— Çift! Fitova unë! — bërtiti Sotiri.

— Zgjidh! — ja ktheu arbitri xha Shaqir.

— Portën e poshtme duam.

— Merreni! Vrap nëpër vënde!

Loja filloi.

Topin në fillim e kishte Ramizi, ky ja pasoi Festimit, Festimi mua. Unë eca para, ja kalova prapë Ramizit. Ramizi e nxori edhe një herë, në krahun tim, por, ç'e do... Ma rrëmbeu topin Kristaqi, që u turr drejt meje si vetëtimë. Ai, pasi gënjeu Meten, ja dha Petraqit, Petraqi prapë Kristaqit, ky shytoi... gol. Tërë fusha buçiti: «Gooool!» Këlyshi i Luftarit nisi të lehë, këmbora e Llaqit sa s'na shurdhoi veshët, kurse Pulia (ç'plakë e çuditëshme!) nuk kuptionim, qeshte, apo kakariste. Kristaqi shkoi

me vrap tek ajo, e puthi dhe i tha me zë të forte, duke u larguar prej saj:

— Gjyshe, tani edhe katër gola kam për të bërë, hë? Pastaj, e di vetë ti...

Xha Shaqiri thirri:

— Gol, gol! Topi në mes të fushës!

Ramizi shkoi me top në qëndër. E vuri në tokë dhe e gjuajti në drejtimin tim. Unë u sula përpara. Kapërceva një kundërshtar, pastaj edhe një tjetër... Sakaq u gjenda ballë për ballë me portjerin. Shytova me gjithë fuqinë... goool! goool! — Gol, — bërtiti edhe xha Shaqiri, — topi në mes të fushës!

Shokët erdhën më përqafuan. Por sheshi nuk gjëmoi nga zërat e tifozëve si në çastin kur bëri gol Kristaqi. Këmbora nuk u ndje. Veçse, si për çudi, këlyshi i Luftarit prapë nis të lehte. E pyeta Luftarin, duke kaluar pranë tij:

— Ç'ka këlyshi yt?

— Hajt, hajt, mos ki gale! — m'u përgjegj Luftari plot gëzim. — Tani ky nuk po qan, por po qesh. Kështu e kanë këlyshët. Nuk kuptohen kur qajnë e kur qeshin. Ndërsa unë i njoh nga surrati.

Në këtë kohë në tërë sheshin kumboi zëri i hollë i plakës Pulie:

— Kristaaaq! Po ikën gjyshja, se kam lenë jamaken<sup>1)</sup> në zjarr, do më digjen fasuuulet!

— Mirë, moj mirë, ikë! — ja priti Kristaqi shumë i mérzitur.

Pas pak iku edhe Llaqi. Ikja e tij u kuptua nga, që këmbora s'po ndihej më. Po edhe sikur të mos kish ikur, si mund t'i binte ai kumborës? «Flaka» e tij e kish humbur fare toruan. Kishte marrë vetëm në atë një çerek ore edhe katër gola të tjerë: një nga Ramizi, dy nga Festimi, e një tjetër nga unë.

Já edhe përfundimi i ndeshjes: 11-2 në fitim të «Rrufesë». Pra, fitorja jonë ishte shumë e thellë. Kjo i detyroi lojtarët e «Flakës» të largoheshin nga sheshi pa na thënë as «natën e mirë!». Por, kur do të iknim edhe ne, xha Shaqiri na thirri:

— Ej, çuna! Hajdeni këtu ca!

Me t'u gjendur pranë tij, ai na pyeti, duke na shtrirë përpara një copë kartë të madhe të bardhë të ngjitur mbi karton:

— Pa më thoni, ç'është shkruar në këtë mukafanë, që gjeta nën këmbët e mijë, tek po ecnja nëpër shesh. Mos është ndonjë nga ato tabellat e atyre të shëndetësisë, që do ta ketë shqitur nga vëndi ndonjë i paudhë?

Ne, si e lexuam shpejt e shpejt, qeshëm fort.

---

1) poçen.

— Hair, hair! Pérse qeshni, de!? — na  
ndërpreu xha Shaqiri.

— Xha Shaqir, këtu është shkruar.

— Hëllo!

— «Ndeshje ndërkontrollare. «Flaka»  
«Rufeja» 13-0. Të gjithë në stadiumin «Xha  
Shaqiri»! Mos humbisni rastin!»

— Jo, more! C'nuk u pjell mëndja lane-  
tërve! — na e ktheu ai, duke ja krisur të qe-  
shurit bashkë me ne.

## 7.

I kisha bërë aq bukur detyrat e arithmeti-  
kës, saqë fillova të habitem edhe vetë. Rrija  
duke i parë dhë kënaqesha. Mësuesi ynë, As-  
triti, me fletoren time të ngritur lart, përparr  
nxënësve thoshte:

— Në këtë klassë paska plot nxënës të mi-  
rë! Pa i shihni pak detyrat e Dritanit! Fletore  
të tillë do t'i ruajmë për ekspozitën e shkollës.

Në këtë kohë Kristaqi uli kokën duke  
mbajtur ballin me dorë. Mësuesi e vuri re, iu  
afrua dhe e pyetoi shqetësuar:

— Kristaq, c'ke kështu? Pa më thuaj! Mos  
të dhëmb koka?

— Po, mësues, më dhëmb pak.

Unë e kuptoja mirë çfarë kishte Kristaqi.  
Edhe shumë shokë të tjerë e kuptionin.

Në pushim çunat thërritën:

«Rroftë Dritani!», «Rroftë Kodra e Sulmit»!

Pas orës së arithmetikës erdhi ora e vizatimit. Mirëpo unë nuk ja kisha mprehur majën lapsit. Hodha sytë nëpër klasë, se mos shihja ndonjë me brisk në dorë, po nuk pashë. Pastaj pyeta me zë të ulët:

— Kush ka një brisk?

Liljana tha:

— Unë s'kam.

Edhe Metja tha:

— Unë s'kam.

— Po ti, Elsa, ke?

— Jo, për kokën e nënës!

Ju afrova Kristaqit. Mbi bangë, pranë flëtores së vizatimit, kishte briskun, gomën dhe bojërat. Po punonte ngadalë e me kujdes. Dukej, se po kënaqej nga vizatimi që po bënte Këtë gjë shumë nga ne e kuptionin lehtë, sepse Kristaqi kish një zakon: në këto raste zgjaste buzët.

I thashë:

— Të lutem, ma jep pak briskun!

— Jo, — m'u përgjegj, — nuk më do qejfi.

— Pse?

— E di vetë.



## 8.

I çuditshëm ishte ky Kristaqi! Mendohesha e mendohesha dhe nuk e gjeja dot përse sillej aq keq, sidomos me mua. Në raste të tilla

më pushtonte një ndjenjë, së cilës as tani nuk e di ç' emër ti vë, urrejtje, habi, apo... Rrija i heshtur e nuk doja të më thoshte njeri as një gjysëm fjale.

Një herë nuk m'u durua. E vendosa: «Do ta zë Kristaqin me të vajtur në shkollë e do kërkoj të bisedoj me 'të për të gjitha ato që kanë ndodhur, në mes ne të dyve.» Dhe ashtu bëra. Pasi e kërkova lart-poshtë, e gjeta. Kishte blerë nga dy copa hallve dhe po i hante mbësh-tetur pranë selvisë, te xhamia e plumbit.

— Mirë mëngjesi! — i tha shë.

— E, mirë mëngjesi, çar do? — ma ktheu, duke u përtypur. S'më erdhi mirë që m'u përgjegj ashtu, po nuk e bëra veten.

— Unë dua të bisedoj me ty, Kristaq.

— Hë, bisedo, çar 'do bisedosh?

— Pse më ke inat? Hajt pajtohemidhe bëhemidi shokë!

— S'dua.

— Sa mëndjemadh që je!

— Do ikësh, apo...

— Pse, do më rrrahësh?

— Po të më nxehësh shumë...

— Mos, ore! Si nuk e ditke që unë ty me një dorë të kam!

— Me një dorë, hë? Mirë. Do ta shikojmë!

— Ma priti dhë au largua me nxitim.

— Po atë ditë, në pushimin e gjatë, nuk

dola nga klasa. U ula në bangën time dhe po i hidhja një sy historisë. Vura re se bashkë me mua kish qëndruar në klasë edhe Kristaqi. Se ç'po bënte atje në bangën e tij. Veç nesh nuk kishte aty asnje nxënës tjetër. Papritur e shoh Kristaqin të ngrihet e të vijë pranë meje i ngrysur.

— E, — më tha, — ti më ke mua me një dorë, hë? Pa bëje një herë provë!

E shikova pa i dhënë përgjegje.

— Një çikë të më prekësh, — vazhdoi, — sikur edhe kaq sa maja e thoit, do të ta fus me një grusht dhe do të të lë top në vend.

Duke qeshur, e pyeta:

— Ç'të paskë hipur, apo mos të ka hyrë miza në tru?

— Mbylle gojën, — m'u çirr, — së do të ta përvesh me sallaken!<sup>1)</sup>

E kapa ngadalë te krahu dhe i thashë, duke e kthyer nga dera:

— Ikë, më lërë tani, se s'kam kohë të merrrem me ty, do përsëris historinë!

— Nuk më duhet, se çar do bësh ti, po hiqe dorën, se do pendohesh!

— Eeej! Po kur qënke bërë kaq trim!?

Në këtë çast dëgjova një lëvizje pas shpine. Ktheva kokën. Edmondi, që paskësh qënë i

1) me dorën e majta.



fshehur poshtë bangave, më kapi në gjoks,  
duke më bërtitur:

— Pse ke thënë përmua që jam kungull?

Aty përmua Kristaqi më mbërtheu fort  
nga beli. Të dyja duart më mbetën të zëna

nën krahët e tij. Ç'duhej bërë? Ky mendim më kaloi në kokë si rrufe: «Sa turp! Të zihem në mes të klasës? Ç'do mendojnë për mua shokët? Po mësuesi? Po drejtori? Po babaj?»

— Do më lëshoni, apo?... — u thashë i nxehur.

— Frikacak! E sheh që ngece? — ma priti Kristaqi me kënaqësinë e një fitimtari. Nuk prita më. U shtërngova sa munda, mora frymë me gjithë mushkëritë dhe, duke e nxjerrë frymën me forcë, bëra një rrotullim të shpejtë. Kristaqi u përplas përdhe. Ndërsa, Edmondi, prej të cilit posa qesh shkëputur, m'u sul përsëri. Atëhere e përfshiva në mes dhe e ngrita përpjetë, gati për ta shukur plot inat. Por kjo nuk ndodhi. Dera u hap me vrull. Frap, e lëshova Edmondin. Përpara nesh qëndronte Vangjeli, komandanti i kompanisë. Kristaqi, që ish akoma shtrirë, sapo e pa, filloi të ngrijhej me mundim, duke mbajtur me dorë bërryllin e gërvishtrur pas bangës. Pas Vangjelit hynë shokë të tjerë të klasës. Të gjithë po na shikonin me përbuzje.

Kjo e papritur e çuditëshme mjaftoi përt'u bërë një mbledhje e posaçme e kompanisë.

Dhe mbledhja nuk vonoi. Ajo u bë menjëherë pas orës së fundit të mësimit. Ishte ftuar, si edhe në mbledhjen e parë, nxënësi i klasës VI, Zoi Gjika, i cili tashmë qe ngarkuar të

ndihmonte kompaninë tonë. Në presidium, veç Zoit, ishin Vangjeli dhe Liljana.

I pari e mori fjalën Vangjeli.

— Sot në klasën tonë, — tha, — ndodhi një gjë e papëlqyer, që nuk u ka hie pionierëve. Gjatë pushimit të madh u gjetën duke u zënë brënda në klasë Dritani, Edmondi dhe Kristaqi. Organizata jonë duhet të mbajë qëndrim. Prandaj po bëjmë sot këtë mbledhje. Tani, ata të flasin vetë.

— Posi, posi. Le të flasin vetë! — u dëgjuan disa zëra. — Të na tregojnë pse u zunë!

— Kush e do fjalën? — pyeti Liljana.

Heshtje. Unë rrija në bangë si mbi gjëmba. Më dukej sikur ma shponin kokën me qindra maya gjilpërash. Sytë më erreshin dhe më digjnin fort. Më bëhej sikur klasa rrotullohej kokëposhtë... C'nuk mendoja: «E ka marrë vesh, vallë, mësuesi? Po sikur tani të vijë në shkollë babaj?...»

Pas kësaj u dëgjua zëri i Kristaqit.

— Dritani ve... vetë më ngacmoi. Edmondi e pa dhe u hodh të më mbronte. Po ai e shtyti. Edhe mua më shtyti. Ja, shikoni si m'u gërvisht bërryli!...

... Atë ditë, kur kthehesha në shtëpi me çantën e librave në dorë, kisha marrë me vete edhe vërejtjen e shokëve të mi. Më dukej sikur ajo vërejtje më rëndonte mbi kurriz si

thes me rërë; më dukej edhe sikur diçka ma shtërgonte kokën, siç shtërgon im atë shar-qintë, kur i provon në janë a-s'janë të pjekur.

9.

Mësuesi hyri në klasë, la regjistrin mbi tavolinë e na pyeti:

- Këtë orë kemi gramatikë, apo jo?
- Po, — iu përgjegjëm me një zë.
- Shumë mirë. Detyrat i kini bërë?
- Po.
- I nxirni mbi bangë!

Futa duart në çantën time prej doku blu, dhe fillova të nxjerr me të shpejtë fletoren.

...Pas pak, sipër bangave zbardhonin fletoret e hapura, kurse unë kisha ngrirë, duke vështruar i habitur fletoren time. Kush t'i kish bërë me njollë boje detyrat e mijë?!

Mësuesi ynë, Astriti, kur arriti pranë meje, qëndroi e më pyetë:

— Pse i paske bërë pis detyrat?

Si t'i përgjigjesh?

— Këtë herë s'po të vë notë, — vazhdoi ai. Pas kësaj, mbase priste që ta falënderoja, ndërsa unë u preka në sedër. Po më ngarkohej një gabim, që s'ish imi. Buza e poshtme se



përse filloi të më dridhej. Sytë m'u mbushën me lot. Duke m'u marrë goja, i thashë mësuesit:

— Jo, po...

— Si?

— Nuk..., nuk... i kam bërë vetë pis.

— Po, atëhere, qysh paska ndodhur kjo?

— S'e di.

Mësuesi, si u mendua ca, më pyeti përsëri:

— Kur i bëre detyrat?

— Mbrëmë.

Pasi mori këtë përgjegje, vuri gishtin mbi njerën nga njollat e bojës. Gishti iu njollos:

— Heej! — tha me gjysëm zëri, duke parë majën e gishtit dhe sakaq iu drejtua klasës:

— Kush nga ju ja ka bërë pis, pa dashur, fletoren Dritanit?

Asnjë nuk iu përgjegj. Qetësia u bë edhe më e madhe, ndërsa mësuesi nisi të ecë i zymtë lart-poshtë nëpër klasë. S'e dija se do t'u jepte aq rëndësi atyre njollave.

Pas pak minutash u ndal pranë tavolinës së vet dhe tha me zë të ngadalshëm e të dëshpëruar:

— Kjo që paska ndodhur më hidhëron shumë!

Heshti një copë herë, shëtitit përsëri nëpër klasë i menduar dhe u vrënjt edhe më tepër. Befas qëndroi e pà u kthye rishtaz:

— A e dini ç'do të thotë t'i bësh keq shokut? Ndoshta jo. Ju jeni ende fëmijë. Por, mbajeni mënd ç'po them: S'ka gjë më të shëmtuar se sa të mos e çmosh shokun, të mos e duash dhe, sidomos, të kërkosh t'i bësh keq. Ky vës dhe tradhëtia janë vëlla e motër. Këtë do ta kuptioni më mirë kur të rriteni. Nuk thotë kot populli ynë: «Pa shok s'del dot në prak të derës».

— Ju i mban mënd partizanët, apo jo? — vazhdoi mësuesi. — Bile, shumë nga prindët tuaj kanë qenë vetë partizanë. Unë i njoh mirë. Babai i Kristaqit ka luftuar në brigadën VII. Edhe babai i Agronit, i Festimit kanë qenë partizanë. Skënderin, t'anë e Dritanit, e kam parë me sytë e mi, kur e morën ballistët, i lidhën duart me pranga dhe e futën në burg... Me siguri ju do të kini dëgjuar mjaft ndodhira ngajeta e partizanëve në mal. Një cigare e pënini dhjetë vetë, me një pagure ujë shuante etjen një çetë e tërë...

Pastaj mësuesi heshti përséri, mori frymë thellë dhe bëri disa hapa përpara drejt bangës së Kristaqit. E vështroi Kristaqin në sy dhe i tha:

— Po, po, Kristaq. Ja, kjo ishte shoqëria partizane, shoqëria e prindërvë tuaj: Një copë bukë, — të gjithë nga një thërrime. Pesë veta bashkë — nën një gunë. Kështu e donin ata

shoku-shokun, kështu e ruanin dhe jepnin jetën për njeri-tjetrin.

## 10.

Posa ra zilja, shokët e Kristaqit më rréthuan tek rrija kokëulur në bangën time.

— Ti e ke fajin, ti, — më qortuan me një gojë e plot inat. — Pse ja tregove njollat e bojës mësuesit? Të mos ja tregoje!

— Po ai vetë erdhi tek unë dhe i pa.

— T'i thoshje që i kishe bërë vettë. E gjennim ne pastaj fajtorin.

— Edhe po të të vinte dysh, punë e madhe! Ti s'ke marrë asnje. Përse të mos e provoje një herë?

— Apo doje të na zëmëroje mësuesin?

Shokët e mi, të cilët në këtë kohë qenë afruar të gjithë dhe po u blenin mëndjen të tjerëve, s'priten më, po ndërhynë aty për aty.

— Mjaft folët kuturu!

— Pse e ngacmoni kot?

— Ai, s'ka faj.

— Ka që ç'ke me 'të, — ua ktheu atyre Agroni.

— Mos na nxeh, Agron, — ja priti Ramizi.

— Pse, ore? O, ky! «Mos na nxeh!». Aranë, se na frikësove!

- Nuk ta mbush syrin?
- Ti? Hiç fare.
- Mos! Se...
- Pa hë, një herë!

Ramizi e shterngoi Agronin me të dyja duart nga jaka e xhaketës.

— Lëshomë, lëshomë! — bërtiti Agroni. Ramizi e shtyti tutje. Shokët e pritën.

Kristaqi tha:

— Agron, pse ke frikë? Hidhju, t'u thashin! Ti e mund atë. Ah, të isha si ti!

— Mjaft, ore, ti, qurravec! Pse i ndez më shumë? — i bërtiti Festimi Kristaqit.

— Qurravec je vetë.

— Kristaq, më mirë pusho, se nga shkaku yt po zihen ata. Apo do që të tregoj... — tha Kristaqit Petraqi.

Kjo ishte një e papritur e çuditëshme për të gjithë klasën. Ç'do të tregonte!? Vec kësaj, ne e njihnim atë për shok të ngushtë të Kristaqit. Kthyem menjëherë sytë nga Petraqi. Rinte pa lëvizur, me njerën dorë në bel dhe e shikonte Kristaqin ashpër. Ç'po ndodhë!?

Kristaqi ja ktheu i skuqur flakë:

— Ti je shpifarak... e di unë.

Atë çast u shtangëm fare. Petraqi shpifarak? Dhe për kë!?. Për Kristaqin? Nuk po u besonim veshëve.

— Shpifarak, hë? Mirë. Dëgjoni, çuna!  
Kristaqi e bëri me njolla fletoren e Dritanit.

— Siii! — shqyen sytë të gjithë.

— Po, po. E pashë vetë. Për kokën e nënës!

— Kur? — e pyetën dhjetë përnjëherë.

— Në pushimin e gjatë. Unë kisha harruar topin këtu. Erdha ta merrja. Hapa derën shpejt, dhe...

— Hë!

— Ky po u hidhte bojë detyrave me majën e penës.

Kristaqi u bë spec i kuq.

## 11.

... — Ajo që bëri Kristaqi është një gjë shumë e keqe — tha Petraqi në mbledhjen e kompanisë, — prandaj them që të marrim masa.

— Petraqi do të jetë bërë shok me Dritanin, që thotë..., — e ndërpren Petraqin Kristaqi.

— Mos fol pa leje! — e qortoi Vangjeli.

Edmondi ngriti gishtin.

— Hë, Edmond!

— Unë nuk do mbaj asnje gjë të fshehur, — tha Edmondi. — Do tregoj edhe gabimin tim. Petraqi ma mbushi mëndjen dhe unë e them vetë që s'kam qënë në rregull. Merrni masa edhe kundër meje. S'ka gjë. Vetëm ta dini të vërtetën... Në atë mbledhje, që bëmë para dy-tri javësh, ja hodhët fajin Dritanit, sidoqë ai nuk bëri fjalë. Pastaj, ju e mbyllët mbledhjen shpejt e shpejt, muarët librat dhe shkuat më vrap në shtëpi. Po Dritani ndoshta s'hëngri as drekë, as darkë atë ditë, aq shumë i prekur mbeti, se s'kishte pasur faj farë. Ja si ka qënë puna: Në mës të orës së gjeografisë, Kristaqi më dërgoi dorë më dorë një letër. E hapa dhe lexova:

«Dritani ka thënë për ty që je kungull. Eshtë e vërtetë që ti je kungull? Unë s'e besoj. Dritani edhe mua më ka thënë që jam ngordhalaq dhe që është i zoti të më rrërahë vetëm me gishtin e vogël. Po sot unë kam vendosur t'i jap një mësim të mirë. Nëqoftëse pranon, bashkohu me mua. Do të jesh më i sigurtë.

Shoku yt  
Kristaqi»

Atë çast mua m'u kujtua, se i kisha thënë një herë Dritanit të më jepte detyrat e arith-

metikës që t'i kopjoja. Po ai ma kish kthyer: «Hajt, të t'i shpjegoj më mirë! Pastaj do shohësh, po nuk të lindi dëshira t'i bësh vetë». Unë s'desa. Dhe ai nuk m'i dha. Prandaj, tek lexoja herë pas here në letrën e Kristaqit fjalën «kungull», thoshja me vete: «Sa çudi e madhe! Më paska sharë pas kurrizit!»

Duke menduar kështu, këputa nga fletorja një fletë dhe shkruajta:

**«Kristaq, buçko!**

Jam në një mendje me ty. T'ja rregullojmë qejfin, karkalecit! Në pushimin e madh do të jem i fshehur poshtë bangave. Ai do të rrijë për të përsëritur historinë. Kështu e ka zakon. Në klasë do të jemi vetëm ne të tre.

**Edmondi».**

Dhe pastaj ndodhi ajo që ndodhi. Megjithëse u mprehëm si dy gjela, nuk ja dolëm dot «karkalecit». Kaq pata. Jo, më falni, se harrova! Nuk i thashë këto që ta rëndoj Kristaqin, po që të bindet se ka faj.

Kur u ul Edmondi, gjithë klasa filloi të lëvizte. Shokët nisën t'i pëshpëritnin njeritjetrit vesh më vesh.

— Ju lutem, qetësi! — tha Zoi Gjika. —  
Kush kërkon të flasë?

— Unë, — u përgjegj Festimi, duke u  
ngritur në këmbë. — Propozoj që ta përjashtojmë Kristaqin nga organizata e pionerit.  
S'kam më.

Kristaqi kish futur kokën në mes të supeve dhe nuk ndihej fare. Të dukej sikur nuk merrte fryshtë.

— Ta përjashtojmë, posa, ta përjashtojmë!  
— u dëgjuan disa zëra të rrëmbyer, menjëherë pas Festimit. Shumicën e kishte pllakosur heshtja.

Kërkova leje të flisja. Të gjithë u kthyen nga unë. «Ç'dënim do të kërkoja për një njeri, që ishte munduar aq shumë të më bënte keq?» Kjo gjë i bënte mjaft kureshtarë.

— Jo! — thashë. — Pse ta përjashtojmë? Nuk ka faj vetëm ai. Edhe unë kam. Edhe shokët e tjerë. Janë ndarë në dy grupe. Disa thérresin: Rroftë «10 Korriku! Rroftë Kristaqi!...» E disa: «Rroftë Kodra e sulmit! Rroftë Dritani!...» Këto gjëra e kanë ndezur Kristaqin më shumë, e kanë bërë që të më ketë cmirë...

Fjalët e mia i dhanë mbledhjes një drejtim tjetër. Shumë shokë u ngritën dhe folën përsëri. Ata pranuan se ato që thashë unë ishin

me vënd. I këtij mendimi ishte edhe komandananti i kompanisë, Vangjeli. Ai u ngrit dhe tha:

— Po, po. Dritani ka shumë të drejtë. Apoj, Agron?

— Pse më pyet mua? — ja ktheu Agroni.

— Si mos të të pyes!? Nuk ishe ti qe cirrëshe si në pyll, «Rroftë Kristaqi»? Hë? Fol!

— Po pse, unë vetëm cirresha? Edhe Festimi cirrej edhe Ramizi, edhe Petraqi.

— Me leje, me leje? — u dëgjua zëri i Lonit të Cacës që andej nga bangat e fundit.

— Ç'ke, Loni?

— Kam një propozim.

— Thuaje!

— Agronin, Festimin, Ramizin, edhe Petraqin, po deshën, t'i vëmë të trëmbin laraskat te selvia e xhamisë, se kanë zë shumë të fortë.

Në çast, klasa qeshi me të madhe. Ndërsa Vangjeli ja ktheu Lonit të Cacës, rëndë-rëndë:

— Ulu! Nuk kemi nevojë për shakara tani. Ty gjithmonë tetë të bie ora.

...Në fund u është iu luta shokëve që t'ja fal-nin Kristaqit, të mos merrnin asnijë masë kundër tij. Por këtë ata nuk e bënë. I hoqën një vërejtje me paralajmërim.

Tek një cep i hanit të xha Shaqirit ishte një tabelë dërrase e mbërthyer në krye të një shtylle të hollë e jo shumë të gjatë druri të ngulur në dhe. Në 'të ishte shkruar: «**Mos hidhi mbeturinat!**» Kurse Loni i Cacës, ai këmbëza e urës, kishte ngjitur me brumë atë pasdite mbi tabelën një copë kartë me këto fjalë:

**«Lajmërim!**

Sot në stadiumin «Xha Shaqiri» skuadra «Rrëmuja» do të provojë forcat me skuadrën «Merre ta marrim». Vëndet për tribunë ruhen falas. Ejani të gjithë! Ndeshja do të jetë mjaf interesante!».

Dhe lajmërimi i Lonit e bëri punën e tij. «Stadiumi» u mbush plot. Ne lojtarët, që përbëheshim vetëm nga nxënës të klasës sonë, e filluan lojën me zjarr. Dhe, kur akoma nuk kishin kaluar as dy minuta, Festimi, ngriti të dyja duart lart dhe thirri:

- Penallt! Metja e bëri penallt!
  - Jo, nuk e bëra. Qafsha të gjithë!
  - Xha Shaqir, penallt qe?
- Po xha Shaqiri s'e kishte mëndjen fare të

loja jonë. Ishte kredhur në muhabet me Kristaqin.

— Po hë, o xha Shaqir, qe penallt, apo s'qe? — e përsëriti pyetjen Festimi.

— Mjaft, or ti, urith! Nuk shikon që s'juas kam ngenë tani? — iu përgjegj xha Shaqiri. E pas pak më thirri mua:

— Dritan, o Dritan, hajde këtu ca!

Shkova. E pashë me vërejtje shokun tonë plak. M'u duk i mërzitur. Kristaqi qe ulur pranë tij dhe i mbante sytë përdhe. Me dorën e majtë shkulte fijet e postiqes së xha Shaqirit.

— Shoku yt, — filloi xha Shaqiri duke hedhur sytë mbi Kristaqin, — m'i tregoi të gjitha fije e për pe. Bile ai më tha që e kupton se ka qenë fajtor kundrejt teje, prandaj është penduar. Edhe në shtëpi ja paskan shkulur veshët mirë. Tani, ja ç'duam të na thuash: do t'ja falësh shokut tënd, apo jo?

— Posi... unë e... e thashë edhe në mbledhje.

— E the, ku e the, s'di gjë unë; këtu ç'thuar?

— Ja fal, xha Shaqir.

— Me zemër, ama, jo me fjalë!

— Me zemër, xha Shaqir.



— Ashtu më rrofsh! Hajt tani, jepini dorën njeri-tjetrit!

Po ne nuk lëvizëm. Unë po shikoja strehët, ndërsa Kristaqi majat e këmbëve. Më vinte turp nga ai. Edhe atij, siç dukej, i vinte turp prej meje. Faqet na qenë bërë prush.

— Hë de, jepini dorën njeri-tjetrit, po them! Ç'më rrini si hunj gardhi, apo t'ju hyj me shkop? — na tha plaku me shaka.

Hodhëm të dy nga një hap përpara, si me përtesë, pastaj edhe nga një hap tjetër. Zgjata dorën e djathtë. E zgjati edhe Kristaqi. I po-qëm. I shtërnguam. U shikuam sy më sy.

— Përqafohuni, hajt, se ju ndërseva qentë e Muharrem Lajës! — nã bërtiti xha Shaqiri përsëri me shaka. Dhe ne u përqafuam e ashtu të përqafuar ndjemë një gëzim të madh.

### 13.

Ichte mesditë. Posa kishim dhënë provimin e gjuhës shqipe. Dielli qe aq i nxehëtë, sa na bënte të plasnim vase. Po ecnim të gjithë me hap të nxituar. Donim të arrinim sa më parë në lumë, te diga, të kënaqeshim duke u larë. Ishim, pothuaj, njëzet vetë. Qemë vënë në rresht për një. Në krye na printe Pëllumbi;

pas tij vinte Festimi. Unë isha andej nga mesi, bashkë me Vangjelin. Kristaqi që në fund. Bënte shakara me Lonin e Cacës.

Kur arritëm te ura e Goricës, u lëshuam me vrap. Osumi, që dukej para syve tanë tek rriddhte pa as më të voglën zhurmë, na tërroqi si me magnet. Rreshti u prish. Gjithsecili mundohej t'ja kalonte shokut.

— Urraaa, urraaa!... — bërtitëm me një zë, kur u gjëndëm buzë lumit. Të gjithë fillum të zvisheshim shpejt e shpejt.

Pas dy-tri minutash, lumi shkumëzon te prej kërcimeve tonë me kokë që nga maja e bregores së vogël. Vëndi rreth e rreth ushton te nga zërat tanë. Kristaqi rrinte anës së ujit, i veshur, dhe na shikonte me zili. Ai kish shumë dëshirë të lahej, por nuk dinte not.

Ne, si u kënaqëm gati një gjysmë ore në ujë, shkuam të gjithë dhe u shtrimë në rërë. Në këtë çast unë vura re Kristaqin që po zvishej. Siç dukej kishte vendosur të lahej patjetër. I shkova pranë dhe i thashë:

— Kristaq, pse po zvishe?

— Do të lahemi edhe unë, — m'u përgjegj,  
— kam shumë vapë.

— Po këtu ka më tëpër se katër metra thellësi; do të mbytesh.

— Pse tē mbytem? Unē aty nē buzē do futem. Uji nuk mē arrin as gjer nē gju.

— Mendohu mirë, se mund tē tē rrëshqasin këmbët dhe, pastaj...

— Jo, jo. Nuk mē rrëshqasin.


— Si tē duash, — ja ktheva, dhe vazhdova tē lahem. Por frikën e kisha nē zemër. Pas kësaj, e pashë Kristaqin tek po futej nē lumë dalëngadalë.

Shokët nisën t'i thërrisin:

— O Kristaq! Ikë, ore, ikë që andej!

Ai nuk fliste, por vetëm ua bënte «jo» me gisht. Loni i Cacës, që nuk i zgjidhte shumë fjalët, iu çirr:

— Ikë, ore budalla, se do ta lësh triskën!



Kristaqi prapë tundëte gishtin... Papritur unë dëgjova:

— Bobo, moj nënëeee! U mbyta!


Ishte zëri i Kristaqit. Ktheva kokën menjëherë. Ai përplasi vetëm pak krahët mbi ujë dhe humbi. Trupi m'u rrënqeth. Zemra m'u drodh nga tmeri që ndjeva. U turra me not. Arrita atje ku pashë Kristaqin për herë të fundit. Thitha ajër me gjithë gjoksin dhe u zhyta kokëposhtë me sytë të hapur. Dy metra më tutje, në thellësi, shquajta trupin e Kristaqit, që lëvizte pa kuptim këmbë e duar. Uji e rrotullonte dhe e merrte me rrëmbim. U dhashë edhe një herë me forcë këmbëve prapa dhe u lëshova drejt tij. Sakaq e mbërtheva nga beli me të dyja duart, kur edhe ai më mbërtheu për beli, sikur po rrokeshim. Dukej që nuk e kisha kapur mirë. Duhej ta tërhoiqja nga flokët, por Kristaqi i mbante të shkurtër. Edhe të gjatë sikur t'i kish, mua përsëri nuk do të më shkonte ndër mend ta tërhoiqja për flokësh. E kisha humbur fare. Ç'duhej të bëja? Dhashë e mora dhe, me mundim të madh, dola mbi ujë bashkë me 'të. Në këtë kohë shokët u sulën të gjithë për të na ndihmuar. Munda të shqiptoj vetëm:

— Heeee!

Pas kësaj, prapë u gjenda në fund të lu-

mit, i mbërthyer fort me Kristaqin, si edhe në fillim. Ishim në rrezik. Fare pak shpresë kisha se do të shpëtonim, megjithëqë dija not shumë mirë. Po sa para bënte? Veçse kishte edhe një rrugë tjetër: T'ja shkëputja duart Kristaqit nga beli im dhe ta shtyja me të dyja këmbët. Por këtë nuk do ta bëja kurrë edhe sikur të mbylesha që në atë çast. Po qe se Kristaqi do të mbetej vetëm, qoftë edhe një minutë, do të mbytej me siguri. Osumi te diga ishte mjaft i gjërë. Hajde ta gjeje, pastaj, qoftë edhe të mbytur!... Bëra përpjekje të dilja përsëri mbi ujë, të merrja edhe një herë frymë, po Kristaqi, që kish humbur ndjenjat, më pengonte. Ish më i rëndë nga unë, më i madh në shtat. Gjoksi sa s'më pëlciste. Nga veshët po më delte gjak. Dhashë e mora dhe ja, më në fund, dola në sipërfaqe. Oh, nuk e tregoj dot gjëzimin e atij casti. Ajër, ajër! Jetë! M'u duk se dola nga varri, sikur i kisha shpëtuar vdekjes nga thonjtë. Kristaqi, fytyra e të cilit qe puqur me timen, ishte bërë krejt mavi. Bobo! Ashtu duhej të isha mavijosur edhe unë.

Shokët na kapën. Filluan të na mbanin të dyve sipër ujit, sikur të ishim rroba e jo njerëz dhe notonin më këmbë drejt bregut. Vangjeli më tha:



— Lëshoje Kristaqin! Tani jemi ne. E märrim vetë.

Por unë nuk e lëshoja. Ende trëmbesha se mos e rrëmbente lumi.

— Lëshoje, de! — bërtiti Pëllumbi, që ish më i madhi ndër ne. Jo, jo. Nuk e lëshoja dot. Atëhere shumë duar shokësh na ndanë me forcë. Më tepër nuk di ç'bënë. I humba ndjejnjat edhe unë...

Kur erdha në vete, pashë rrreth meje shokët me fytyra të prera, që na shkundnin edhe mua edhe Kristaqin. Pyeta me zë të mekur:

— Kristaqi, si është Kristaqi?

— Po merr frymë, — m'u përgjegj Festimi. — Nxori gjithë atë ujë. Ja, edhe për pak, besoj, do të flasë.

Por mua më dridhej ende zëmra. Dhe vërtet ai foli:

— Nëne!

Atëhere të gjithë m'u hodhën në qafë. Më puthën nga katër e pesë herë. Unë qava, siç duket, nga gëzimi. Kisha shpëtuar një shok!

Kristaqi, kur u qetësua, u kthyte nga unë dhe më tha, me zë aq të ulët, sa mezi e dëgjova:

— Dritan! Të falem nderit!...

## 14.

Dëftesat do të ndaheshin, të dielën. Në mëngjes u zgjova shumë herët. Nata më qe dukur mjaft e gjatë dhe gjumin nuk e kisha bërë të qetë.

Me t'u afruar pasditja, fillova të pregatittem me gëzim. Vesha bluzën prej basmajë ngjyrë qielli me dy xhepa, dhe pantallonat e shkurtra blu. Sandalet e zeza i leva me bojë dhe i fërkova fort, gati një gjysëm ore, me një copë kadife që e kisha gjetur në lekkat e jastëkut.

Kur po përqafohesha me nënën, para se të nisësha për në shkollë, në portë u dëgjua një trokitje, e pastaj një zë:

— O Dritan!

E kuptova menjëherë cili qe: Kristaqi. Sa

m'u bë qejfi! Ai kishte ardhur të më thërriste mua që nga lagjeja e tij, që ishte shumë larg prej lagjes sime, me qëllim që të shkonim në shkollë të dy bashkë.

...Oborri i shkollës ishte stolisur për bukurin. Në dritaren e klasës së V-të, mbi portën e madhe, valëvitej flamuri ynë. Dy tavolina qenë nxjerrë para hyrjes dhe ishin mbuluar me beze të kuqe. Mbi 'to qe vënë një vazo me lule. Përballë tavolinave qenë vendosur njera pas tjetrës tre radhë bankash, të cilat shpejt e shpejt u mbushën me prindërit tanë. Nuk vonoi shumë dhe nga porta e shkollës doli xha Todi me zilen në dorë. Atë ditë ai kishte veshur kostumin e ri, që e mbante vetëm në festat. Pasi hodhi një vështrim rrëth e rrotull, nisi t'i bjerë ziles. Por dukej që nuk ishte i gëzuar dhe i qeshur si në ditën e parë të fillimit të vitit shkollor. Me siguri atij i vinte keq që po ndahej nga ne, sepse na donte si fëmijët e tij.

Kur kaluan edhe pessë minuta, përpara dy tavolinave zunë vend mësuesit dhe në mes tyre drejtori. Në ças në të gjithë oborrin shpërthyen duartrokitjet. Pastaj shoku Koço, siç e thërrisnin prindërit drejtorin, nisi të mbajë fjalim. Si mbaroi fjalimi, ai filloi t'u shpërndante fleta lavdërimi nxënësve të dalluar.

Ja! Erdhi edhe çasti i pritur me pađurim.  
Drejtori po thoshte:

— Nga klasa IV A...

Ishte klasa jonë. Zemra nisi të më rrähë  
me forcë.

— ... për nota të shkëlqyera në mësime,  
— vazhdoi drejtori, dhe për sjellje shembu-  
llore brënda dhe jashtë shkollës, i jepet fletë  
lavdërimi nxënësit Dritan Mara.

— Urraaa!... — bërtiti i pari Kristaqi,  
duke përplasur pëllëmbët fort, saqë tërroqi  
vëmëndjen e të gjithëve, dhe m'u hodh në  
çafë. Menjëherë pas tij bërtitën shokët e kla-  
sës, si në meting, e bashkë me 'ta duartrokitën  
të téré sa ishin. Festimi u sul tek unë si vetë-  
timë. Ramizi, Petraqi dhe Loni i Cacës, më  
pushtuan sa s'më zunë frymën. Babai erdhi me  
vrap e më rrëmbeu. Balli i ndrinte. Sytë i  
qeshnin.

— Shpejt, — më tha, — shpejt, shko jepu  
dorën mësuesëve!

Kur akoma s'qesh kthyer tek shokët, u  
dëgjua përsëri zëri i drejtorit. Qëndrova në  
vend. Ai tha:

— I jepet, gjithashtu, fletë lavdërimi nxë-  
nësit Kristaq Shpiragu.

Shpejtova hapin t'i delja Kristaqit përp-  
ara, dhe sakaq u gjëndëm të përqafuar.

— Ej, — dëgjova nja dy zëra, — mjaft u përqafuat!

... Atë pasdite shokët e klassës na dhuruan ne të dyve, mua dhe Kristaqit, librin «Timuri dhe skuadra e tij». Në kapakun e librit ishin shkruar pastër dhe bukur dy emra: DRITAN-KRISTAQ.



**Redaktor: Moisi Zaloshnja**  
**Korektor letrar: Ali Hashorva**  
**Piktore: Dolli Gjinali**  
**Red. Teknik: Adem Lita**

**Tirazhi 6000 kopje      Format 70x100 32      Stash: 2204—53**

---

**Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tiranë 1965**

## LEXONI KËTO LIBRA

Lekë

|               |  |    |
|---------------|--|----|
| Aleks Çaci    | Na hoqën çatinë (novelë)                         | 15 |
| Andrea Varkli | Një histori e lashtë stërgjyshore                | 15 |
| Loni Papa     | Ne gjahtarët e fshatit dhe<br>Lica jonë e dashur | 25 |

çmimi lek 10